



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 28.02.2025

Nr: 221

Ora: 12:00

VENDIM

PËR

**SHQYRTIMIN ADMINISTRATIV BAZUAR NË DENONCIMIN ME NR. 08 ID, DATË
10.02.2025, TË REGJISTRIT TË DENONCIMEVE,
TË PARTISË DEMOKRATIKE/PD**

Sot më datë 28.02.2025, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve mori në shqyrtim çështjen administrative me:

KËRKUES: Partia Demokratike

SUBJEKT: **Z. Erion Isai**
Kryetar i Bashkisë Kolonjë

OBJEKT: Përdorimi i burimeve publike dhe funksionit publik në mbështetje të subjekteve zgjedhore nga z. Erion Isai, Kryetar i Bashkisë Kolonjë

BAZA LIGJORE: Neni 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n” dhe pika 2, neni 91, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe neni 3, pika 3, të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator, të ndryshuar

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

KONSTATOJ:

Partia Demokratike, ka paraqitur denoncimin në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, më datë 10.02.2025, nëpërmjet adresës së postës elektronike e-mail, denoncimin e administruar në regjistrin e denoncimeve me nr. 08 ID.

Në këtë denoncim Partia Demokratike parashtron sa vijon:

Data: 28.02.2025

Nr: 221

Ora: 12:00



“Për shqyrtimin administrativ, bazuar në denoncimin me nr. 08 ID, datë 10.02.2025, të regjistrin të denoncimeve, të Partisë Demokratike/PD”

1. "Kryetari i bashkisë Kolonjë ka nisur të shpërdorojë fondet publike për të udhëtuar drejt Greqisë dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës, me qëllimin e vetëm për të bërë fushatë politike dhe për të ndikuar te emigrantët për zgjedhjet e datës 11 Maj 2025".
2. "Z. Isai në kundërshtim të hapur me ligjin regjistron emigrantët në PER në favor të Partisë Socialiste, duke përdorur funksionin e tij publik për të favorizuar një parti politike".

Me vendimin nr. 99, datë 14.02.2025, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve (KSHZ), u vendos fillimi i procedurës administrative, për shqyrtimin e këtij denoncimi. Bazuar në këtë vendim j'u kërkua personave përgjegjës në Bashkinë Kolonjë, që të paraqesin prapësimet në lidhje me çështjen objekt hetimi.

Më datë 28.02.2025, ora 12:00, u zhvillua seanca publike për këtë shqyrtim administrativ. Në këtë seancë u paraqitën Kryetari i Bashkisë Kolonjë, z. Erion Isai dhe përfaqësuesi i Partisë Demokratike z. Franci Nuri, të cilët i qëndruan pretendimeve të depozituara me e-mail në KQZ.

Nga hetimi administrativ u provua se postimet, ripostimet dhe pëlqimet janë bërë në faqet personale të rrjetit social "Facebook" të z. Erion Isai, subjekt i këtij denoncimi.

Sa më sipër, në lidhje me postimet e publikuara në faqen personale të Kryetarit të Bashkisë Kolonjë, me përmbajtje hashtag, slogane apo thirrje të karakterit elektoral/politik, duke promovuar kështu subjektin zgjedhor, pas verifikimit të kryer, u vlerësua se postimet në llogaritë personale të tij, nuk mund të përbëjnë prova të mjaftueshme për të provuar lidhjen midis postimit dhe shkeljes administrative. Kryetari i Bashkisë është edhe funksionar politik dhe si i tillë mund të postojë në faqen personale mesazhe politike, promovim të nismave politike, takimeve me bashkatdhetarët apo çdolloj mesazhi tjetër politik.

Marrëdhëniet personale apo postimet në llogaritë personale në Facebook të Kryetarit të Bashkisë, dalin jashtë fushës së zbatimit dhe objekti të rregullimit të Kodit Zgjedhor dhe akteve normative në fuqi dhe si të tilla nuk mund të trajtohen nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Parashikimi i ndalimeve për sa i përket këtyre postimeve me natyrë politike interferon në liritë themelore siç janë liria për t'u shprehur si dhe liritë dhe të drejtat politike.

Referuar pjesëmarrjes së z. Erion Isai, në aktivitetet e kryera jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, "Takim me shqiptarët" të publikuara në rrjetin e tij social "Facebook", nuk rezulton e provuar që pjesëmarrja e tij të jetë në cilësinë e Kryetarit të Bashkisë, pasi takimet e zhvilluara nuk provohen të kenë patur lidhje me detyrat funksionale dhe institucionale.

Po ashtu, nuk rezultoi e provuar se thëniet në këto aktivitete përbëjnë një bazë të mjaftueshme për të vërtetuar lidhjen e pjesëmarrjes në takime me cilësinë e postit që ai mban. Çdo person, pavarësisht postit që mban, si funksionar i partisë ku aderon, mund të jetë pjesëmarrës në aktivitete dhe të shprehë mendimet e veta, apo preferencat politike, gjithmonë pas orarit zyrtar të punës dhe jashtë mjediseve të institucioneve shtetërore.

Referuar veprimtarive të mësipërme objekt denoncimi, rezultoi e provuar nëpërmjet shkresës nr. 50 prot. datë 07.01.2025 të Bashkisë Kolonjë me objekt "Kërkesë për leje të zakonshme", se këto aktivitete janë kryer gjatë kohës që z. Isai ka qenë me leje vjetore.

Prezenca e z. Isai, nuk lidhet me detyrat e tij funksionale si Kryetar i Bashkisë Kolonjë dhe për rrjedhojë nuk jemi përpara shkeljeve të parashikimeve ligjore në fuqi.

Për sa më sipër, duke qenë se gjatë hetimit administrativ nuk u arrit të provohej shkelja e neneve 91 dhe 92, të Kodit Zgjedhor dhe nenit 3, të Vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator, vlerësoj se duhet të pushohet hetimi administrativ për këtë denoncim.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n” dhe pika 2, nenin 91, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, në nenin 3 pika 3 e vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator, të ndryshuar,

V E N D O S:

1. Pushimin e shqyrtimit administrativ të denoncimit nr. 08 ID, datë 10.02.2025, ndaj:
 - Z. Erion Isai, Kryetar i Bashkisë Kolonjë.
2. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen palëve nëpërmjet adresës së postës elektronike.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI